

VENDIM
Nr.376, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, 14 e 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b.2” e pikës 11.7.1. “Procedura për ngritjen në kategoritë C2 dhe C1”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b.2. Komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve për kategoritë C2 e C1 përbëhet nga:

- | | |
|--|----------|
| - zëvendësministri i Financave | kryetar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |
| - drejtori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik | anëtar; |

Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik propozohet nga dekanati i këtij fakulteti dhe miratohet nga kryetari i komisionit të përzgjedhjes.”.

2. Fjalja e parë e paragrafit të dytë të shkronjës “b.2” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik përfiton një shpërblim ditor, për çdo ditë pune në komision.”.

3. Shkronja “b” e pikës 11.8 “Procedura për ngritjen në kategoritë B e A”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b. Komisioni i përzgjedhjes për kategoritë B dhe A përbëhet nga:

- | | |
|--|----------|
| - zëvendësministri i Financave | kryetar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |
| - drejtori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik | anëtar. |

Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik propozohet nga dekanati i këtij fakulteti dhe miratohet nga kryetari i komisionit të përzgjedhjes.”.

4. Nën-pika 11.9.5 e pikës 11.9 “Procedura e rekrutimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“11.9.5. Komisioni i përzgjedhjes, për rekrutimin e nëpunësve, nëpërmjet konkurrimit të hapur, përbëhet nga:

- | | |
|--|----------|
| - zëvendësministri i Financave | kryetar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |
| - drejtori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik | anëtar. |

Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik propozohet nga dekanati i këtij fakulteti dhe miratohet nga kryetari i komisionit të përzgjedhjes.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha